



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 2, Datë 11.01.2016

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

KONSTATON:

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat "a" dhe "c", dhe pika 3 e këtij neni, nenit 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka ndjekur të gjithë hapat që parashikon procedura e hetimit, për të shqyrtuar ankesën Nr. 129, datë 26.12.2014, të paraqitur nga subjekti ankues z. kundër kompanisë Albpetrol sh.a Patos, për diskriminim për shkak të lidhjes familjare.

Bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 164, datë 19.11.2015, me anë të të cilit në pikën 1 është vendosur: "Konstatimin e diskriminimit të shtetasit për shkak të lidhjes familjare në formën e viktimizimit, nga ana e shoqërisë Albpetrol sh.a". Në pikën 2 të këtij vendimi Komisioneri ka vendosur që: "Shoqëria Albpetrol sh.a, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e z. ë vendin e mëparshëm të punës". Palët e interesuara kanë marrë dijeni për vendimin.

Bazuar në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", si dhe në pikën 3, të Vendimit nr. 164, datë 19.11.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albpetrol sh.a, duhet të raportonte, brenda 30 ditëve, para Komisionerit për veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi duke bërë me dije Komisionerin për masat e marra.

Në drejtim të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka ardhur asnjë shkresë nga Albpetrol sh.a, në të cilën të njoftoheshin veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Komisionerit.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Për sa më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se Albpetrol sh.a, është në shkelje të parashikimeve të bëra në pikën 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", pasi nuk ka zbatuar vendimin nr. 164, datë 19.11.2015 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTË ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa "ç", nenin 33, pikat 11, 12, 13/b e 14 të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Albpetrol sh.a, të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Gjoba të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
3. Zbatimi i vendimit nr. 164, datë 19.11.2015 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda shtatë ditëve nga marrja dijani për sanksionet, sjell shfuqizimin e tyre.
4. Subjekti, Ministria e Punëve të Jashtme, duhet të njoftojë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përputhje me sa parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al